



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 529 Prot.

Gjirokastrë, më 15.05.2020

VENDIM

Nr. 19, datë 15.05.2020

PËR

- A. MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MASAT HIGJENO-SANITARE, ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRATIVE MBI MINIMIZIMIN E RISKUT NGA COVID-19 NË INSTITUCIONIN ARSIMOR UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR";
- B. MIRATIMIN E STRUKTURËS TË ZHVILLIMIT TË PROCESIT MËSIMOR NË PERIUdhËN QERSHOR-TETOR 2020;

Mbështetur në ligjin 80/2016 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nen 37 dhe 38; statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" nen 13, urdhërin e MASR nr. 104, datë 30.04.2020 "Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga Institucionet e Arsimit të Lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID-19"; urdhërin e MSHMS nr. 105 "Për marrjen e masave higjieno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë edhe COVID-19 në institucionet arsimore"; udhëzimin e ISHP-së "Për masat ndaj COVID-19 që duhet të merren në institucionet arsimore; vendimin e Rektoratit të Universitetit "Eqrem Çabej" nr. 06, data 07.05.2020 "Për zhvillimin e procesit mësimor edhe në auditore në universitetin "Eqrem Çabej", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 15.05.2020 diskutoi për rregulloren me objekt masat higjieno-sanitare, organizative dhe administrative mbi minimizimin e riskut nga covid-19 në institucionin arsimor universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë si dhe mbi strukturën e grafikut të zhvillimit të procesit mësimor sipas njësive kryesore dhe

VENDOSI:

1. Të miratojë e rregulloren “Për masat higjeno-sanitare, organizative dhe administrative mbi minimizimin e riskut nga Covid-19 në institucionin arsimor Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër”.
2. Të miratojë strukturën e propozuar nga njësitë kryesore për zhvillimin e procesit mësimor si më poshte:
 - 2.1 Vazhdimi i mësimdhënjes on-line për të gjitha programet dhe ciklet e studimit deri në plotësimin e javëve të ploga të parashikuara në planin mësimor, duke përfshirë edhe kompesimin e dy javëve të humbura (09.03.20 deri në 20.03.2020).
 - 2.2 Kthimi i studentëve në auditor për vitet e treta bachelor, vitet e dyta master profesional, vitet e dyta programe profesionale 2-vjeçare për përsëritjen e leksioneve dhe seminareve, për zhvillimin e punëve laboratorike dhe praktikave profesionale, brenda muajit qershor për jo më pak se 3 javë mësimore, duke respektuar distancimin fizik dhe standartet higjeno-sanitare.
 - 2.3 Provimet për studentët që diplomohen dhe mbrojtja e diplomës të zhvillohen në periudhën java e fundit e muajit qershor – java e parë e muajit gusht.
 - 2.4 Kthimin e studentëve në auditor për programet e viteve të para dhe të dyta bachelor, për vitet e para të programeve master profesional, për vitet e para të programeve profesionale 2-vjeçare, në periudhën java e fundit e gushtit – java e fundit e muajit tetor për të zhvilluar të gjitha proceset mësimore (leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, provime, diplomim etj.).
 - 2.5 Zhvillimin e praktikave profesionale dhe laboratoreve në masën jo më pak se 50%, sipas modaliteteve të përcaktuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga njësitë kryesore.
 - 2.6 Në periudhën shtator – tetor të jetë edhe sezoni i vjeshtës për provimet e prapambetura dhe mbrojtjen e diplomës.
 - 2.7 Njësitë bazë në përputhje me strukturën të hartojnë grafikët (oraret) e zhvillimit të procesit mësimor (leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, provime, diplomim etj.) për të dyja periudhat: qershor – java e parë e gushtit 2020 dhe java e fundit e gushtit – java e fundit e tetorit 2020, në përputhje me rregulloren “Për masat higjeno-sanitare, organizative dhe administrative mbi minimizimin e riskut nga Covid-19 në institucionin arsimor Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër”. Për çdo orë mësimore të përcaktohen: nr i sallës, kapaciteti në m² dhe numuri i studentëve në proporcion me këto kapacitete, sipas studimit të bërë nga institucioni i administratorit. Grafikët të miratohen nga drejtuesit e njësive kryesore.

3. Një kopje e rregullores "Për masat higjeno-sanitare, organizative dhe administrative mbi minimizimin e riskut nga Covid-19 në institucionin arsimor Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë" i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi zv/Rectori për procesin mësimor, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë, sektori i standarteve dhe korrikulave, sekretaria mësimore e institucionit.

Ky vendim lryn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
Prof. dr. Bektash MEMA

